



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 346/2024

Datë: 23/09/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 10 (paragrafi 5) të Rregullores Nr.17/2024 të Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit Nr. 17/2024, të datës 30.01.2024

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2 e Vendimit nr. 17/2024, të datës 30.01.2024 dhe shtohen pikët si në vijim:

2.68. Projekt Udhëzim Administrativ për qasjen e Ministrisë së Drejtësisë në sistemin e Evidencës Penale (10.10.2024).

2.69. Projekt Udhëzim Administrativ për Procedurat Disiplinore për Administratorët Falimentues (15.10.2024);

2.70. Projekt Udhëzimi Administrativ për Organizimin dhe Administrimin e Provimit për Administratorët Falimentues (15.10.2024);

2.71. Projekt Udhëzim Administrativ për Tarifat e Administratorëve Falimentues (15.10.2024);

2.72. Projekt Udhëzimi Administrativ për mënyrën e raportimit të Administratorëve të Falimentimit (15.10.2024);

2.73. Projekt Udhëzimi Administrativ për punën e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e kandidatëve për Administrator Falimentues (15.10.2024);

2.74. Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën e mbajtjes së trajnimit, kushtet për të trajnuarit, kompensimin, si dhe rregullat për kandidatët të cilët e kanë kaluar provimin për noterë (30.10.2024);

2.75. Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën, përgjegjësinë, autorizimet dhe të drejtat e qasjes dhe administrimit të SIPL (30.10.2024);

2.76. Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën, përgjegjësinë, autorizimet dhe të drejtat e qasjes së noterëve në sistemin informativ noterial si dhe shkëmbimin e informatave me institucionet tjera (30.10.2024);

2.77. Projekt Udhëzim Administrativ për Mënyrën e mbajtjes së dokumenteve që krijohen në formë elektronike (30.10.2024);

2.78. Projekt Udhëzim Administrativ për Regjistrin Elektronik të Testamenteve (30.10.2024);

2.79. Projekt Udhëzim Administrativ për nënshkrimin elektronik noterial (30.10.2024);

2.80. Projekt Udhëzim Administrativ për qasjen elektronike dhe shfrytëzimin e regjistrave publikë (30.10.2024).

2. Ndryshohet dhe plotësohet pika 3.8 dhe 3.9 e Vendimit nr. 17/2024, dt. 30.01.2024 dhe shtohen pikët si në vijim:

3.8. Departamenti Ligjor, dhe pika 2.68;

3.9. Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika,
dhe pikët 2.69, 2.70, 2.71, 2.72, 2.73, 2.74, 2.75, 2.76, 2.77, 2.78, 2.79 dhe 2.80.

3. Projekti fillestar sipas paragrafit 2 të këtij vendimi, i përfunduar i dërgohet Departamentit Ligjor të Ministrisë së Drejtësisë për shqyrtim sipas afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Departamenti Ligjor pas përfundimit të shqyrtimit e procedon gjithë dokumentacionin për shqyrtim dhe miratim në pajtim me Rregulloren Nr.17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Albulena HAXHIU
Ministre e Drejtësisë

Vendimi i'u dërgohet:

- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë,
Profesione të Lira dhe Statistika;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*